



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Nr Prot 937/17

Pogradec, më 14.10.2025

Njoftim për konsultim public

Titulli : Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Propozuesi : Projekt-Vendimet janë propozuar nga Ekzekutivi/ Kryetari i Bashkisë, z. Ilir Xhakolli.

Sqarime për projekt-aktin: *Nevojat e komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike dhe investimeve bazuar në buxhetin 2026-2028*

Kalendari i konsultimit : *Aktivitetet organizohen sipas kalendarit të konsultimit publik bashkangjitur këtij njoftimi*

Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e mëposhtëm për PBA 2026-2028:

<https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/-vkb-nr-85-dt-25-09-2025-pjesa-1-.pdf>

<https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/-vkb-nr-85-dt-25-09-2025-pjesa-2.pdf>

Pjesëmarrës nga ana e Bashkisë dhe e Këshillit bashkiak:

- Anëtarët e Këshillit Bashkiak,
- Përfaqësues nga ekzekutivi,
- Anëtarët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit të Bashkisë Pogradec,
- Kryetarja e Aencës së Grave Këshilltare
- Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik,
- Zyra e Financës së Bashkisë
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Format e konsultimit :

- **Konsultim me takime fizike.**
- **Vjelje mendimi nëpërmjet postës dhe postës elektronike.**

Qëllimi i këshillimit publik	<i>1. Evdientimi i nevojave të komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike bazuar në projekt- buxhetin 2026 dhe Paketën Fiskale.</i>
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	Miratimi i projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike të shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sygjërimet e qytetarëve për mënyrën se si janë përdorur fondet gjatë vitit 2025, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe listën me shërbime / funksioneve nga e cila komuniteti për zgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme.
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon : 1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë? 2. Cilat jane nevojat tuaja per te cilat duhen permiresuar sherbimet nga ana e Bashkise? 3. Cilat janë shërbimet prioritare për të cilat bashkia duhet të shpenzojë më shumë fonde publike gjatë periudhës 2026 – 2028? 4. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur? Tjetër
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh, Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë;

	3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor; 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; Monitorimi i zbatimit të tij.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme.	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit tone : Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Kontaktet dhe afatet e degimit të komenteve, rekomandimeve, verejtjeve	Sygjerimet janë të mirëpritura deri më datë 20 Nëntor 2025, në adresën e email: Jona.bojko@hotmail.com
Data e publikimit	Datë 14/10/2025

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO



Kalendar i konsultimit publik

Titulli i Procesit të Konsultimit Publik : Mbledhja e rekomandimeve per Projekt Buxhejin 2026 dhe per Paketën Fiskale 2026.

Propozuesi : Këshilli Bashkiak, Bashkia Pogradec.

Sqarime për projekt-aktin : Duke qënë se miratimi i Buxhejit 2026 dhe Paketës Fiskale kërkojnë marrjen e mendimit të banorëve në mbështetje të plotë të nenëve 18, pika 1), 54 e Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" si dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Pogradec për "Konsultimin Publikë" miratuar me VKB nr. 42, datë 05/03/2020, si dhe Rregullores për ankesat, kërkesat dhe petitionet iniciativat qytetare të Këshillit të Bashkisë Pogradec, miratuar me VKB nr. 67, datë 01/06/2020, Kryesia e Këshillit me vendim nr 24, datë 13/10/2025, vendosi fillimin e procesit të konsultimit publik me të gjitha grupet e interesit

Grupet që do të konsultohen: Banorët e Njësive Administrative dhe Bashkisë Pogradec.

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1.	Takim me banorët e Njesise Administrative Dardhas	11.11.2025	Fshati Dardhas	11:00	Takim publik	Diskutime.
2.	Takim me banorët e Njesise Administrative Cerrave	11.11.2025	Fshati Cërravë	13:00	Takim publik	Diskutime.
3.	Takim me banorët e Njesise Administrative Bucimas	12.11.2025	Fshati Bucimas	11:00	Takim publik	Diskutime.
4.	Takim me banorët e Njesise Administrative Udenisht	12.11.2025	Fshati Udenisht	13:00	Takim publik	Diskutime.
5.	Takim me banorët e Njesise Administrative Proptisht	13.11.2025	Fshati Proptisht	10:00	Takim publik	Diskutime.
6.	Takim me banorët e Njesise Administrative Velcan	13.11.2025	Fshati Velcan	12:30	Takim publik	Diskutime.
7.	Takim me banorët e Njesise Administrative Trebinjë	14.11.2025	Fshati Trebinjë	10:00	Takim publik	Diskutime.
8.	Takim me banorët e Bashkisë Pogradec	18.11.2025	Salla e Këshillit Bashkiak	12:00	Takim publik	Diskutime.
9.	Takim me gratë dhe vajzat	19.11.2025	Salla e Këshillit Bashkiak	13:30	Takim publik	Diskutime.
10.	Takim me të rinjtë	20.11.2025	Salla e Këshillit Bashkiak	13:30	Takim publik	Diskutime.
11.	Takim me diasporën dhe migracionin	21.11.2025	Salla e Këshillit Bashkiak	12:00	Takim publik	Diskutime

Sekretare e Këshillit: Jona Bojko